



Thirrje për Programin e Praktikave për të Rinjtë

Ftojme të gjithë të rinjtë nga Rajoni Lindor për t'iu përgjigjur thirrjes për programin për praktikë të projektit "Të rinjtë në Agrobiznes- Regjioni Ekonomik Lindor," i cili ju mundëson të rinjve të kenë një eksperiencë në fushën e agrobiznesit, veçanërisht **në përpunimin e pemëve dhe perimeve, përpunimin e qumështit, përpunimin e mishit, përpunimin e drithërave dhe thertoreve.**

Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian, menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatuar nga Komuna e Gjilanit si palë kryesore, në bashkëpunim me komunitatet: Kaçanik, Hani i Elezit, Viti, Shtërpçë, Partesh, Klllokot, Ranillug, Kamenicë dhe Novobërdë.

Qëllimi i kësaj praktike është që praktikantët e suksesshëm të gjejnë një punë të përhershme.

Praktika do të zgjatë tre muaj dhe është me pagesë.

Në këtë program të praktikave do të përfshihen 53 të rinj ku: do të jenë në përpunimin e pemëve dhe perimeve, në përpunimin e qumështit, në përpunimin e mishit, në përpunimin e drithërave dhe në thertore.

Praktikantët duhet të jenë të moshës 18-30 vjeç, prioritet do t'u jepet atyre që kanë diplomuar nga shkolla profesionale bujqësore, që nuk kanë përvojë, që vijnë nga zonat rurale dhe në momentin e aplikimit kanë një deklaratë të papunësisë nga Zyra e Punësimit.

Kandidatët e interesuar duhet të aplikojnë në linkun e mëposhtëm:

ENG: <https://forms.gle/VTXPd21xy96mBSzQ9>

ALB: <https://forms.gle/z4Lbgmfk832Dlbon6>

SRB: <https://forms.gle/d4RYA29C41UDVrUc9>

Ose përmes dorëzimit të aplikacionit në Zyrën e Kryetarit, Bulevardi i Pavarësisë, pn, Gjilan

Perioda e Aplikimit: 25 Nëntor 2019- 27 Dhjetor 2019